

RRETHANAT SOCIO-EKONOMIKE NË MBRETËRINË E  
SHQIPËRISË 1928-1939

TEMA PER TITULLIN  
MASTER I ARTEVE NË DEPERTAMENTIN E HISTORISË

NGA  
LUMTURIJE MORINA



UNIVERSITETI I PRISHTINËS „HASAN PRISHTINA”,  
FAKULTETI FILOZOFIK  
DEPARTAMENTI I HISTORISË  
PRISHTINË

NËNTOR, 2021

## **EKspoZE E TEMËS**

### **RRETHANAT SOCIO-EKONOMIKE NË MBRETËRINË E SHQIPËRISË 1928-1939**

**Mentor:**

**Prof. Dr. Ibrahim Gashi**

**Kandidatja:**

**Lumturije Morina**

Qëllimi bazë i këtij punimi është analizimi i situatës ekonomike në Mbretërinë Shqiptare në vitet 1928-1939. Procesi i konsolidimit dhe demokratizimit të institucioneve në Shqipërinë e peridhës mes dy luftave të gjurmë dhe në rrafshin ekonomik e social të vendit. Pikërisht qëllimi i punimit është të analizojë faktorët kyç që ndikuan në krijimin dhe jetësimin e politikave ekonomike e sociale kryesisht gjatë periudhës së monarkisë.

Metodologjia e hulumtimit e përdorur në këtë punim është e përbërë nga metoda të kombinuara përshkruese, statistikore dhe përdorimi i të dhënave kryesisht sekondare. Për përgatitjen e punimit do të mblidhen të dhëna përmes përdorimit të literaturës shkencore dhe profesionale nga autorë të ndryshëm, si dhe përdorimit të botimeve nga revistat shkencore në fushën e historisë dhe shkencave sociale, si dhe dokumentacionit zyrtarë. Ndër të tjera do të shfrytëzohen edhe statistikat nga arkivat, të cilat përmbajnë informacion lidhur me zhvillimin ekonomik e social në Mbretërinë Shqiptare.

Punimi është i ndarë në tre kapituj. Në pjesën e parë është bërë analizë mbi gjendjen ekonomike, politike e sociale të Shqipërisë, në prag të shpalljes së monarkisë. Arritjet dhe dështimet e Republikës Shqiptare nën udhëheqjen e Ahmet Zogut janë çështje të tjera të trajtuara në këtë pjesë. Kapitulli përfundon me trajtimin e politikës së jashtme të shtetit shqiptar gjatë kësaj periudhe kohore.

Në pjesën e dytë është trajtuar shpallja e Monarkisë së Shqipërisë dhe marrëveshjet e ekonomike e tregtare me Italinë gjatë kësaj periudhe. Paktet e nënshkruara me Italinë i hapën rrugë depërtimit italian si në rrafshin ekonomik dhe social të vendit, ashtu edhe në atë politik. Gradualisht ekonomika shqiptare u bë e varur nga huat dhe ndihmat financiare të shtetit italian, duke u përgatitur kështu momentumi historik i 7 prillit të vitit 1937.

Kapitulli i tretë përfshin pjesën qendrore të punimit. Në këtë pjesë është analizuar ndikimi i krizës ekonomike botërore (1929-1933) në jetën ekonomike e sociale të Shqipërisë. Depresioni i madh pati ndikim të thellë në një shtet me ekonomi të varfër siç ishte shteti shqiptar. Gjendja e vështirë arriti kulmin në vitet 1935-'36, kur qeveria shqiptare u detyrua të shpërndajë ndihma ushqimore emergjence në zonat e varfra. Punimi vazhdon me analizimin dhe krahasimin e zhvillimeve në pothuajse secilën degë të ekonomisë shqiptare; zhvillimi i industrisë, agrokulturës dhe zhvillimi infrastrukturor gjatë këtyre viteve janë vetëm disa nga aspektet e trajtuara në këtë pjesë, duke vënë theksin gjithmonë tek të arriturat the ngecjet e Shqipërisë në rrafshin ekonomik dhe social, në periudhën e mes dy luftrave.